



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep: DPK Nr Prot: 03-03/1265/18
 Nr. llog: _____ B/ Prot: _____
 Nr. vites: _____ Datum: _____
 Nr. pages: 03 Datum: 30.04.2018

DATE/A:	27.04.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1243/18
PËR/ZA/TO:	z. Nexhat KRASNIQI Menaxher i zyrë së Prokurimit Ministria e Infrastruktures
CC:	z. Nebih SHATRI, u.d. Sekretar i Përgjithshëm- Ministria e Infrastrukturës =
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Shërbime për hartimin e projekteve të ndryshme te strukturave” me nr. të prokurimit 205/18/2598/211, nr. të brendshëm MI 18/050/211.

I nderuar z. Krasniqi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Shërbime për hartimin e projekteve të ndryshme te strukturave”** me nr. të prokurimit 205/18/2598/211, nr. të brendshëm MI 18/050/211, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Shërbime për hartimin e projekteve të ndryshme te strukturave”** me nr. të prokurimit 205/18/2598/211, nr. të brendshëm MI 18/050/211, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 26 prill 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokollit: AKK-03-03-1243/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Shërbime për hartimin e projekteve të ndryshme të strukturave**” me nr. të prokurimit 205/18/2598/211, nr. të brendshëm MI 18/050/211, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, llojit shërbime, me vlerë të madhe të parashikuar 225,000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që në njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: “*Vlera e projekteve të realizuara nga lëmia e projektimit, në tri (3) vitet e fundit, 3 (tri) projekte në lëmin e projektimit Rrugëve dhe ura dhe që kapin vlerën jo ma të vogël se 300,000.00 euro, urat do të jenë min 2 ura me gjatësi 100-200m dhe gjerësi 10-15m*”, kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2 parashihet se “Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënenëshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë”.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se këtë rast do të duhej të kërkohej lista e kontratave të bashkangjitura me referenca për përfundimin e kontratave në vlerë totale për të gjitha shërbimet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, e jo si në rastin konkret ku kërkohej 3 (tri) projekte në lëmin e projektimit Rrugëve dhe ura dhe që kapin vlerën jo ma të vogël se 300,000.00 euro.

Konsiderojmë se kërkesat e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët kanë një kapacitet të kënaqshëm ekonomik, teknik-profesional.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 29.6 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Agjencia pas trajtimit të dokumentacionit për tenderin me titull: “Shërbime per hartimin e projekteve të ndryshme te strukturave” me nr. të prokurimit 205/18/2598/211, nr. të brendshëm MI 18/050/211, ju njofton me të gjeturat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

